



Tiranë më 25.11.2015

## AKT DHURIMI

**Drejtuar: z. Arif TAFANI**  
**Kryetar i Bashkisë BELSH**

I nderuar z. Kryetar,

Studio PROJECT & PEOPLE shpk, pasi ka studjuar zhvillimin e hapsirës urbane të Bashkisë Belsh, që ju drejtoni, në drejtimet kryesore si zhvillimi i turizmit, zhvillimi urban etj., konkludoi me hartimin e projektit të qendrës së qytetit.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të krijojë “Ansamblin Rilindja”, një project ku synohet të rifitohet lidhja e humbur e qendrës së qytetit me liqenin duke krijuar një ansambël pedonal qendror i cili do ti ofrojë, banorëve e bizneseve të qytetit por edhe vizitorëve, një qendër me të gjithë elementet e saj, promenadën buzë liqenit, gjelbërimin, vende shlodhëse, forum qytetar dhe aktivitete, shatërvanë, skulptura arkitektonike, objekte me fasada të rikonstruara, molin e drunj të turistik duke i dhënë identitet një qyteti që shtrihet buzë liqenit.

Studio PROJECT & PEOPLE shpk, në vazhdim të projektimit të qendrave të Rilindjes në qytetet shqiptare, nëpërmjet këtij Akt Dhurimi, i kalon në pronësi pa shpërblim projektin e “Ansambllit Rilindja” Belsh, për të ndihmuar konkretisht zhvillimin e Bashkisë tuaj.

Duke ju uruar suksese në zbatimin e këtij projekti,

Me respekt!

PROJECT & PEOPLE shpk

Administratori

Ark. Arben GOLEMI

